



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:029813

Datë: 30.11.2020

Numri i dokumentit: 01306587

**P.nr.556/2014**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Sabedin Mushica, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Blerina Hyseni, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh. M, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KRPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.273/14, të datës 08.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik me datë 01.10.2020, i shpallur me datë 05.10.2020, ndërsa i përpiluar me datë 04.11.2020, këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Sh. M, nga babai Sh., dhe nëna N., e lindur B., i lindur me datë ..., Komuna e Gjilanit, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i punësuar në pikën e karburantëve Komuna e Gjilanit, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 3 të KPPK-së,

**LIROHET NGA AKUZA**

Sepse, me datë 14.06.2013, në kohë të pacaktuar, në Komuna e Novobërdës, në zyrën e noteres L. K..., të pandehurit me qëllim të përfitimit të kundër ligjshëm pasuror në bashkëkryerje me personin N.N. e kanë vërtetuar kontratën mbi shitbljerjen e paluajtshmërisë të ngastrave kadastrale P-..., P-..., P-..., P-... dhe P-..., ZK Novobërdë, ndërmjet kinse kontraktuesve S. S si shitës dhe Sh. M si blerës, në atë mënyrë që fillimisht i akuzuari F. R me personin N.N. e kanë falsifikuar një pasaportë me nr.... të lëshuar nga organet e Republikës së Serbisë në emër të S. S ashtu që personi N.N. kinse pronar i paluajtshmërisë sipas fletës poseduese të datës 12.06.2013, pronë e evidentuar në emër të të S. S, ashtu që të njejtën pronë e kanë bartur në emër të Sh. M, në këtë mënyrë e kanë vënë në lajthim organin kompetent-noteren për të vërtetuar një qështje të pavërtetë.

-Me çka kishte për të kryer veprën penale, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

-I dëmtuari S. S, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil

-Shpenzimet e procedurës penale bien barrë e mjeteve buxhetore të gjykatës

## A R S Y E T I M

### **1.Historiku i procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve**

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm, me datë 08.05.2014, ka dorëzuar në këtë gjykatë, aktakuzën me numër PP.II.nr.273/2014, të datës 08.05.2014, kundër të akuzuarve F. R për shkak të dy veprave penale, legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 KPRK-ës dhe të akuzuarit Sh. M, për shkak të veprës penale, Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës<sup>1</sup>.

Gjykata, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin Gjyqësorë-publike, të cilat shqyrtime kanë vazhduar deri më datë 01.10.2020, në të cilin ka prezantuar Prokurorja e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, e cila gjatë tërë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, ndaj të akuzuarit Sh. M, duke i propozuar gjykatës që të njejtin ta shpall fajtorë dhe ta dënoj në bazë të ligjit<sup>2</sup>.

I akuzuari F. R, gjatë tërë rrjedhës së procedurës është deklaruar i pa fajshëm dhe në fjalën e tij përfundimtare i ka propozuar gjykatës që ta liroj nga akuza.

### **2.Provat e administruara – personale dhe materiale**

- Deklarata e dëshmitarit B. I e dhënë në polici me datë 17.01.2014.
- Deklarata e dëshmitarit L. M e dhënë në prokurori me datë 14.02.2014.
- Deklarata e dëshmitarit T./ M e dhënë në polici me datë 20.01.2014.
- Deklarata e dëshmitarit T. M e dhënë në prokurori me datë 14.03.2014.
- Deklarata e dëshmitarit B. I e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 10.10.2019.
- Deklarata e dëshmitarit R. R e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 10.10.2019.
- Deklarata e dëshmitarit L. M e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 30.10.2019.
- Deklarata e dëshmitares L. K e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 14.01.2020.
- Fleta poseduese me numër ... e datës 01.04.2005.
- Çertifikata e vdekjes me numër serik V... e datës 14.03.2014 në emër të B. M.
- Çertifikata e lindjes me numër serik ... e datës 14.03.2014 në emër të T. M.
- Çertifikata e pronësisë e datës 16.10.2014 në emër të B. M.
- tre urdhër pagesat.

<sup>1</sup> Me aktvendimin procedural të datës 10.09.2019, është veçuar procedura penale ndaj të akuzuarit F.I R, ku ndaj të njejtit gjykata ka lëshuar edhe urdhër për letërrishtim, por deri më tani për organet e policisë i njejtë është i pakapshëm.

<sup>2</sup> Në shqyrtimin gjyqësor të datës 10.10.2019, prokurorja e shtetit ka hequr dorë për dëgjimin e dëshmitarit S. K për shkak se i njejtë në bazë të shkresave të lëndës vërehet qartë se ka të bëjë vetëm me të pandehurin F. R, ku procedura penale ndaj të njejtit është veçuar.Po ashtu në shqyrtimin gjyqësor të datës 01.10.2020, ka hequr dorë nga dëgjimi I të dëmtuarit S. S, në cilësi të dëshmitarit, për shkak se i njejtë në bazë të konstatimit në fletdërgesë dhe në konstatimin e zyrtarëve policor shihet se i njejtë jeton në Austri.

- prokura me numër LRP.nr.2975/2013 e datës 23.10.2013.
- Raporti i vlersimit të paluajtshmërisë me numër 47/2013 e datës 01.11.2013 e lëshuar nga D. për U...në Novo Bërd.
- Kontratat mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër LRP.nr.1129/2013 dhe LRP.nr.433/2013.
- Atkvendimi i gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novo Bërdë me numër C.nr.50/2013 e datës 15.11.2013.
- Çertifikata e pronësisë e datës 12.06.2013 në emër të Stojadin Steviq.
- Kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë me numër të Referencës 172/2013 dhe 130/2013 e datës 14.06.2013.
- Kopja e letërnjotimit në emër të B. M e lëshuar nga misioni i administratës së përkoshme-OKB.
- Kopja e pasaportës në emër të B. M me numër ... e lëshuar nga autoritetet e Republikës së Serbisë.
- Kopja e pasaportës në emër të S. S me numër ... e lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë.
- Kopja e pasaportës në emër të S. S me numër P... e lëshuar nga shteti i Austrisë.
- Kopja e letërnjotimit në emër të Stojadin Steviq me numër ....
- Raporti i hetuesit me numër 2014-KE-30 i datës 29.01.2014.
- Çertifikata e pronës me numër ... për ngastrën Kadastrale ... në K. Novo Bërdë.
- Mbrojtja e të akuzuarit e dhënë në shqyrtim gjyqësor me datë Sh. M 27.02.2020.

### **Pretendimet e refuzuara**

Gjykata me aktvendimin procedural të datës 27.02.2020 e ka refuzuar, propozimin e prokurorisë që gjatë marrjes në pyetje të të akuzuarit Sh. M, të ballafaqohet me deklartatën e dhënë në polici me datë 16.01.2014, për shkak se në polici deklartatën e ka dhënë në cilësi të dëshmitarit, dhe duke e marrë parasysh faktin se dëshmitari dhe i akuzuari kanë tretmane të ndryshme sipas KPP-ës, ku dëshmitari e ka për obligim që të flasë të vërtetën dhe nuk guzon asgjë të hesht, përpos në ato raste kur e inkriminon vetvetën, ndërsa i akuzuari mund të mos të tregojë të vërtetën dhe i njëjti mundet që të mbrohet në heshtje.

### **Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve**

**Nga leximi deklaratës së dëshmitarit B. I të dhënë me datë 17.01.2014 në polici, konstatohet se kishte theksuar se me datë 23.10.2013, në zyrën e tij të Noterisë e cila gjendet në Gjilan, diku pas dite, janë paraqitur dy persona , ku njëri prej tyre ka qenë i nacionalitetit sërb dhe kanë kërkuar që si Noter të përpilojë një Autorizim gjeneral në lidhje me një pasuri të paluajtshme të cilën e posedonte personi i nacionalitetit sërb e që i njëjti ia ka prezentuar dokumentin e identifikimit “Pasaportë”, të lëshuar nga MUP Sërbia-Beograd, dhe pas identifikimit nga ana e tij shihej se personi ishte B. M, i nacionalitetit sërb, i lindur në Novo Bërd, dhe i njëjti njëkohësisht ia ka prezentuar çertifikatën e pronës, ku shihet se prona që gjendej në emrin e B. M, i njëjti ka kërkuar që t’ia plotësojë një Autorizim dhe pasi që e ka identifikuar personin në bazë të dokumentit që ia ka prezentuar ,e ka aprë se janë përputhur të dhënat me çertifikatën e pronës e datës 16.10.2013 dhe sipas detyrës zyrtare dhe përgjegjësisë që i ka si noter e ka përpiluar Prokur, me të cilin B. M e autorizon F. R nga Gjilani, që të veprojë në emër të B. M., që i njëjti ta shes, përfaqësojë para të gjithë organeve në Republikën e Kosovës. Pas plotësimit të kësaj prokure nga ana e noterit, palët në fjalë të njëjtën e kanë firmosur dhe një kopje të të dokumentit identifikues të të dyjave e ka ndalur në dosje,**

certifikatën e pronës së datës 16.10.2013 dhe një kopje të prokurës, ashtu që palërt pas kësaj janë larguar nga zyra.

Pas disa ditësh, gjersa ishte në një trajnim në Prishtinë, kolehja notere L. K..., gjatë bisedës me të njejtën e ka pyetur në lidhje me këtë prokurë të cilën e ka përpiluar ky, mirëpo për shkak të sigurisë i ka thënë se pa e parë lëndën nuk dinë se cka ti thotë, dhe pasi që është kthyer në zyrë e ka gjetur lëndën dhe një kopje të pasaportës i ka dorëzuar kolegës L. K., në zyrën e tij, e cila dyshonte se personi në fotografi nuk është B. M i vërtetë.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit L. M të dhënë në prokurori me datë 14.02.2014, konstatohet se personin F. R më parë nuk e ka njohur, por sa imkujtohet dy javë para lidhjes së kontratës F. R e ka takuar te pompa e benzinës aty ku punon vëllau i tij të në me të njejtin janë takuar dhe kanë biseduar ku i njejt i ka thënë a po ma bënë transferin e pronës e cila gjendet te Kolegji ..., ky i ka thënë po, nëse nuk është kundërligjore dhe se i njejt i ka garantuar se është krejt ligjore dhe këtë puna e ka kryer në aspektin human, pas këtij takimi pas dy jave kanë shkuar te noteri në dhe e kanë përpiluar kontratën mbi shitblerjen e kësaj aplajtshmërie dhe të njejtën e kanë nënshkruar, dhe se nuk e dinë se sa sipërfaqe ka blerë por nuk e di edhe qmimin e kësaj marrëveshje, pasi që nuk ka qenë i interesuar, por vetëm në aspektin human dhe se nuk i ka shkuar mendja se do të ketë pasoja dhe se me datë 29, 30 dhe 31.10.2013 ka bërë pagesa në shumë prej nga 10.000 Euro, edhe atë në llogai të F. R dhe se këtë shumë ia ka dhënë F. R, ashtu që nëpërmjet llogarisë së tij të kalojnë tek llogaria e F., kinse në emër të kësaj shitblerje dhe se i njejt nuk ka përfituar asgjë nga kjo shitblerje, por vetëm ka humbur edhe ato të holla që kanë qenë për mirmbajtjen e kartelsës dhe se nuk e ka bërë bartjen në emrin e tij në kadastërt dhe po ashtu as pronën e cila evidentohet në bazë të kontratës ... e datës 01.11.2013, nuk e ka bartur në emrin e tij dhe se këtë e ka bërë vetëm për hir të vëllaut të tij dhe se personin B. M. e njeh pak se kanë pirë kafe dikund në rrugën qarkore dhe se i njejt i ka thënë se jeton dikund në Sërbi dhe se këtë perosn asnjëher nuk e ka parë në Gjilan apo në.

**Dëshmitari B. I në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar:** se me datë 23.10.2013, në zyrën e Noterisë e cila gjendet në diku pas dite ishin paraqitur në zyrën e tij dy persona, ku njëri nga ta ka qenë i nacionalitetit Serb dhe kishin kërkuar nga Noteri të përpiloj një Autorizim gjeneral në lidhje me një pasuri të paluajtshme të cilën e posedonte personi i nacionalitetit Serb, e që i njejt i kishte prezentuar dokumentin e identifikimit - pasaportën të lëshuar nga MUP Serbia-Beograd dhe pas identifikimit nga ana e tij, shihej se personi ishte B. M, i nacionalitetit Serb, i lindur në, Komuna e Novobërdës dhe i njejt njëkohësisht kishte prezentuar certifikatën e pronës, ku shihej se prona që gjendej në emër të B. M, e cila pronë gjendej në fshatin, tutje i njejt kishte kërkuar nga noteri që tia përpiloj një Autorizim, e pas identifikimit në bazë të dokumentit të prezentuar, kishte ardhur në përfundimin se përputheshin të dhënat me certifikatën e pronës të dt. 16.10.2013 dhe sipas autorizimeve ligjore që i posedon si Noter, kishte përpiluar Prokurën, me të cilën B. M me të cilën kishte autorizuar F. R nga Gjilani që të veproj në emër të B. M, me të cilin i njejt autorizohet që të mund ta shiste pronën në fjalë, ta përfaqësoj para të gjithave organeve të Republikës së Kosovës. Pas përpilohet të kësaj Prokure, palët në fjalë të njejtën e kishin firmosur dhe një kopje të dokumentit identifikues të të dyja palëve e kishte vendosur në dosje, së bashku me certifikatën së pronës së dt.16.10.2013 dhe një kopje të Prokurës, ku me pas palët ishin larguar nga zyra e tij. Tutje ka shtuar se në zyrën e tij nuk posedon ndonjë paisje të veçantë për vërtetimin e dokumenteve të identifikimit dhe certifikatave të pronës, ndërsa në rastin konkret ka deklaruar se ka vepruar konform dispozitave ligjore mbi noterinë dhe se nuk kishte pasur as dyshimin më të vogël se diçka nuk ishte në rregull me dokumentacionin e prezentuar nga palët, ndërsa informatat e para lidhur me këtë çështje i kishte pranuar nga Noterja L. K... e cila në bazë të njohurive që kishte

lidhur me atë zonë ku gjendet paluajtshmëria kishte dyshuar se nuk ishte B., e pasi që ishte kthyer në zyrën e tij kishte kontrolluar edhe një herë dosjen në fjalë në mos eventualisht i kishte ikur ndonjë gjë, por që kishte konstatuar se sa i përket dokumentacionit gjithqka ishte në rregull. Të akuzuarin Sh. M ka deklaruar se nuk e njeh dhe se i njëjti nuk figuron të ketë kryer ndonjë shërbim tjetër në zyrën e tij noteriale.

**Dëshmitari R. R në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar:** nga prokurori i shtetit janë njoftuar i cili i kishte udhëzuar që të shkonin tek noterja L. K... për ti marrë disa dokumente për shkak të dyshimit se ishte kryer një vepër penale, ashtu që të njëjtit ishin shkuar pranë noteres për ti marrë shkresat dhe e njëjta ua kishte dorzuar ato, ngase edhe vet noterja kishte dyshuar në këtë rast. Gjatë hetimeve kishin vërejtur se e tëtë pasuria e B. M ishte tjetërsuar nga një prokurë e cila ishte nënshkruar nga një erson i rremë, në mënyrë që tërë pasurinë të kishte të drejtë ta shesë apo tjetërsoj, ndërsa kishin kuptuar se B. i vërtetë kishte vdekur para 30 viteve kurse familjarët e tij ishin duke jetuar në shtetin e Serbisë, të cilëve ua kishin prezentuar pasaportën e B. M por që askush nga ta nuk e kishte njoftur. Nipi i B. M, T. M i cili ishte intervistuar në SP Gjilan kishte konstatuar se në pasaportën e prezantuar nuk e njihje personin i cili ishte në foto dhe se gjyshi i tij kishte vdekur në vitin 1978, dhe B. i vërtetë kishte pasur 6 fëmijë, ku dy prej tyre kishin vdekur ndërsa 4 tjerë janë gjallë dhe pasuria e B. është ende e pa ndarë, dhe nga kjo pasuri F. pasi që e kishte bartur në emër të vetë një pjesë ia kishte shitur një personi të quajtur L. M. Poashtu Noterja L. K ...i kishte njoftuar edhe për një rast për të cilin ka dyshuar, ku pas ndërmarrjes së hetimeve kishin gjetur se F. kishte gjetur një person të quajtur S. S i cili ia kishte bartur një sipërfaqe të paluajtshmërisë personit Sh. M. Gjatë hetimeve kishin gjetur se S. S i vërtetë jeton në Austri dhe i njëjti nuk kishte shitur asnjë pronë, e po ashtu të dhënat e S. S të rremë nuk kishin qenë identike me S. S e vërtetë. Lidhshmëria në mes F. dhe Sh gjatë hetimeve kishte rezultuar se Sh. ta mirrte një përqindje prej F. për shkak se Sh. e barte pronën në emër të tij. F. kishte njoftuar se me Sh. kanë qenë shokë. Në atë kohë ka konsideruar se fletën poseduese kishte mundur që ta tërhiqte vetëm pronari legjitim ose personi i autorizuar. Atëherë nuk iu kujtohet se a kishin gjetur ndonjë kërkesë që e kishin kërkuar për ta tërhequr fletën poseduese, mirëpo e din që kanë qenë në kataster në Novobërdë. Sh. M gjatë hetimeve e kishim kuptuar se është i implikuar në këtë rast të S. S dhe të njëjtin e kishim intervistuar dhe i njëjti nuk ishte paraqitur vetë për ndonjë dyshim të kësaj prone. Dëshmitari tha se nuk kishte njohuri që Sh., S i cili ishte paraqitur që ti kishte dhënë të holla për këtë paluajtshmëri dhe se F. i kishte thënë se arsyeja pse pronën ia kishte qitur në emër të Sh. është se F. kishte shumë prona në emër të tij dhe pasi që të fillojë ti shesë pronat një përqindje tia jap edhe Sh.

**Dëshmitari B. S në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar:** se është e vërtetë që një person me emrin B. S ka jetuar dhe se i njëjti ka ndërruar jeta para një viti, ndërsa S. S është babai i B. S, dhe i njëjti jeton në shtetin e Austrisë së bashu me familje, kurse B. kishte vdekur në Austri por që ceremonia e varrimit ishte kryer dhe se ai personalisht kishte marrë pjesë në varrimin e të njëjtit.

**Dëshmitari L. M në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar:** se kishte dhënë deklaratë në Prokurori lidhur me çështjen në fjalë por që nuk i është kujtuar përmbajtja e saj, duke shtuar tutje se F. R nuk e kishte njohur më heret por që vetëm rastësisht e kishte takuar tek pika e derivateve të Komunës së Gjilanit, ku kishte punuar vëllau i tij Sh. M, ku F. R i kishte dhënë se është shok i vëllëakut të tij Sh. ashtu që kishin pirë kafe dhe kishin shkëmbyer numrat e telefonit, e pas një kohe F. R i kishte telefonuar për tu takuar në Gjilan, ku më pas F. R i kishte dhënë shumën prej 10.000€ të tia transferojë përmes llogarisë së tij bankare në llogarinë e F. R, të cilin e kishte pyetur se a është në dijeni vëllau i tij Sh. për këtë çështje, por që ai ishte

përgjigjur se ai personalisht do tia spejgoj Sh.. Gjatë kësaj kohe ka shtuar se ai dhe vëllau i tij Sh. kishin qenë të ndarë por që raportet i kishin të mira mes vete, por që kushtet financiare i kishte të vështirsuara dhe se ishin në mungesë të ujit të pijshëm, për të cilin fakt e kishte njoftuar F. R, i cili i kishte kërkuar që të transferojë shumën në fjalë, me kushtin që pasi që të transferoheshin këto mjete, i njëjti do tia hapte një bunarë për uj të pijshëm, por që i njëjti nuk e dinte se në cilën llogari bankare i kishte transferuar ato para pasi që F. ia kishte dhënë një numër të xhirollogarisë të cilin edhe e kishte prezentuar në bankë me rastin e transferimit të parave, e pastaj pas 2 apo 3 ditëve F. R i kishte dhënë edhe një shumë të hollave prej 10.000€ me të cilat kishte kërkuar nga L. M që të veprojë njëjti duke i transferuar në llogarinë e njëjtë bankare. Pas një jave i kishte treguar F. R se ishte i interesuar që të blejë tokë dhe ai i kishte treguar se mund ti gjejë tokë afër kolegjit ...dhe se së bashku me pronarin e tokës kishin shkuar tek noterja në ku edhe i kishin nënshkruar kontratat, e pas këtij rasti më nuk ishte takuar asnjëherë me F. R. Në ballafaqimin e prokurores së shtetit lidhur me deklaratën e dhënë prokurori me datë 14.02.2014, dëshmitari L. M ka deklaruar se nuk është e vërtetë se prej F.R ka marrë shumën prej 30.000€, po nga i njëjti ka marrë dy herë nga 10.000€, ndërsa Sh. M nuk kishte asnjë njohuri lidhur me shitblerjen e tokës e as të transfereve bankare.

**Dëshmitarja L. K, ... me profesion Notere, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar:**

se tre persona kishin shkuar në zyrën e saj, prej të cilëve njëri prej tyre ishte sërëb dhe ishte prezantuar si S. S, dhe dy persona tjerë F. R dhe Sh. M, por që nuk i është kujtuar se cili prej tyre e kishte pyetur se çfarë dokumentacioni duheshin por që të njëjtit kishin ardhur me dokumente në dorë dhe se fjala ishte për një kontratë për shitblerjen e paluajtshmërive për pronën e cila figuronte në të S. S dhe që ndodhej në zonën kadastrale të . Të njëjtit kishin më kishin prezentuar fletën poseduese për të dëshmuar se e njëjta pronë nuk ishte e hipotekuar, se Komuna nuk ishte e interesuar për blerje, ashtu që noterja ua kishte kërkuar dokumentet identifikuese, ku të njëjtit i kish prezentuar pasaportën në emër të S. S dhe fotografinë e personit i cili kishte qenë prezent, ashtu që e njëjta kishte menduar se është S. S, ndërsa Sh M i kishte prezentuar letërnjoftimin, ashtu që noterja kishte kosideruar se gjithçka ishte në rregull, për të vazhduar me paralajmërimet ndaj tyre se nuk guxojnë të deklarohen rrejshëm për shpërlarje të parave, për shmangje nga tatimi. Diku ka fundi i vitit 2013 kishte kuptuar se S. S jetonte në shtetin e Austrisë dhe se i njëjti nuk vinte asnjëherë në Kosovë, ashtu që e njëjta kishte bërë lajmërimin në Prokurorinë e Shtetit ku edhe kishte dhënë një deklaratë, para se ti lindnin dyshimet se Sh. M ua kishte shitur Xh. M tri parcela, ndërsa Sh. I ia kishte shitur një parcelë. Tutje ka shtuar se personi i cili gjendet në gjykatë është personi i cili kishte qenë prezentë në zyrën e saj duke aluduar në të pandehurin Sh. M.

**Dëshmitari T. M në deklaratën e tij të dhënë në polici me datë 20.01.2014,** ndër të tjera ka deklaruar se : është nipi i B. M, Komuna e Novobërdës, përndryshe pronar i pasurisë së paluajtshme e regjistruar sipas Fletës Poseduese nr. Certifikata UL-..., e lëshuar nga zyra e t pranë Komunës së Novobërdës, se i ndjeri B. M i ka pasur 6 fëmijë dhe atë dy vajza dhe katër djem, nga të cilët i ndjeri M. M, i ndjeri, B. M babai i tij dhe djemtë të cilët ende janë në jetë Zh. M me vendbanim në Nish dhe S. M gjithashtu me vendbanim në Nish, gjersa vajzat R. M-A, me vendbanim në dhe R. M.-K, me vendbanim në Krushevc, kurse pasuria e paluajtshme udhëhiqet në emër të gjyshit të tij të ndjer B. M, i njëjti ka ndërruar jetë në vitin 1978. Tutje ka shtuar se nuk e di e as që kishte dëgjuar nga axhallarët e tij të kishin ndërmarrë veprime rreth bartjes së pasurisë së paluajtshme të lartëcekur në emër të trashëgimtarëve të tjerë. Fotografitë e prezentuara i kishte parë dhe ka deklaruar se ky person nuk është familjar i tij e as që e kishte njohur të njëjtin.

**Dëshmitari B. S në deklaratën e tij të dhënë në polici me datë 17.01.2014, ndër të tjera ka shtuar** se është i punësuar në shtetin e Austrisë ku edhe jeton me familjen e tij, ndërsa sa i përket rastit ka deklaruar se paluajtshmëria në fjalë është pronë e babait të tij S. i cili po ashtu jeton në shtetin e Austrisë dhe se është person me afëtsi të kufizuara, ashtu që kishte dëgjuar se një person i panjohur për të te kishte tjetërsimin e paluajtshmërinë dhe se personi me emrin S. S është i pa njohur për të. Tutje ka shtuar se është i mirë njoftuar nga ana e babait të tij që ai askujt nuk i kishte dhënë autorizim që ta punoj apo ta tjetërsoj, e po ashtu babai i tij është person me aftësi të kufizuara dhe se nuk ka mundur që askujt ti jap ndonjë autorizim.

### **Mbrojtja e të akuzuarit Shaban Muji**

Në deklaratën e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësore i akuzuari Sh. M ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila i bie barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, ngase ka konsideruar se këtë vepër i njëjti nuk e ka kryer, për faktin se i njëjti kishte shkuar tek noteri në mënyrë të rregullt, e kreyte kjo pasi që ai ishte duke punuar në vendin e tij të punës tek pompa e derivateve, Komuna e Gjilanit, ku kishte ardhur F. R me të cilin kishin raporte shoqërore më herët ngase me të njëjtin edhe kishin punuar së bashku si muzicient, ashtu që nga vendi i tij i punës kishin shkuar së bashku tek noterja L. K..., ku më pas në zyrën e noteres kishte ardhur edhe personi i quajtur S. S të cilin më heret nuk e kishte takuar asnjëherë, ashtu që i kishin dhënë dokumentet e nevojshme noteres për përpilimin e aktit, ngase F. R kishte blerë katër parcela, ndërsa arsyeja se përse këto parcela ia kishte bartur atij në emrin e tij nuk e dinte dhe asnjëherë nuk e kishte kuptuar por që tani i ka kuptuar pasojat e këtij veprimi, e sa i përket përfitimit material ka shtuar se asnjëherë nuk ka përfituar. Arsyeja se përse nuk kishte ruajtur asnjë kopje të kontratës së shitblerjes së paluajtshmërie ishte për faktin se ai nuk kishte ndonjë plan po që qëllimi i tij i vetëm ishte që ti kryente një shërbim mikut të tij F. R, e po ashtu ishte në dijeni që F. mirrej me shitblerjen e paluajtshmërive dhe se i njëjti ishte porositur se në rast se ndokush ishte i interesuar për blerje atëherë ta lajmëronte të njëjtin por që nuk e dinte se për çfarë çmimi bëhej fjalë. Tutje ka shtuar se kontratat e shitblerjes i kishte bërë me vetëdije pasi që nuk kishte dyshuar në qëllimin e F. R dhe se i njëjti i kishte thënë që toka pasi të kalojë në emrin tij, pastaj të njëjtën do ta bartnin në emër të F. R, e se krjte kjo bartje bëhej për faktin se S. S jetonte në Serbi, ku pas kalimit të disa muajve e kishte thirrur F. R dhe i kishte thënë që ta bartë pronën e lartcekur në emër të tij pasi që Sh. M kishte për të udhëtuar në shtetin e Kanadasë, ashtu që F. R i kishte thënë që do ta bëjnë një gjë të tillë. Më pastaj të njëjtin e kishte sërish F. R i cili i kishte thënë se një pjesë të tokës ua kishte shitur një personi të quajtur N. apo Xh, ashtu që kishte shkuar tek noterja dhe ia nënshkuar kontratën e shitblerjes, e po ashtu pas një kohe F. R, ia kishte shitur edhe një pjesë tjetër një personi emri i të cilit nuk i është kujtuar, por që në kohën e nënshkrimit të këtyre kontratave nuk kishte qenë në dijeni të pasojave ligjore që do të mund të shkaktonin veprimet e tija. Në ballafaqimin e prokurores së shtetit lidhur me deklaratën e dhënë në prokurori me datë 14.02.2014 se “ a është e vërtetë se F. të ka dhënë shumën prej 1500€ me zor”, i njëjti ka deklaruar se nuk është e vërtetë që ti ketë marrë ato mjete, ndërsa ka shtuar se ndihet i tradhtuar andaj nga gjerat që kanë dalur ndihet përgjegjës.

### **Vlerësimi i provave**

Nga Certifikata e Pronësisë me numër ...e datës 01.04.2005, gjykata gjeti se paluajtshmëria objekt i kësaj çështje penale juridike evidentohet në emër të M.B (T.) ...dhe atë me 1/1 e pjesës së pronësisë, në zonën kadastrale të në mes tjerash pronat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi edhe atë .. dhe ... nuk evidentohen në këtë flet poseduese.

Nga Certifikata e Vdekjes me numër Serik ... e datës 14.03.2014, e lëshuar nga ZGJC në Novo Bërdë, gjykata gjeti se B.(T) M ka vdekur me datë 10.06.1978 në tani Komuna e Novo Bërdës.

Nga Certifikata e Lindjes me numër Serik ... e datës 14.03.2014, e lëshuar nga ZGJC në Novo Bërdë, gjykata gjeti se T. M, nga babai B. M, ka lindur me datë ...

Nga Certifikata e Pronësisë e datës 16.10.2013, gjykata konstatoi se paluajtshmërit evidentohen në emër të B.(T.) M atë me 1/1 e pjesës së pronësisë, në zonën kadastrale të Koretishtës,po ashtu edhe në këtë flet poseduse parcelat si në dispozitivin e këtij aktgjykimi edhe atë ... dhe ..., nuk evidentohen.

Nga urdhër pagesat e datave 29.10.2013, 30.10.2013 dhe 31.10.2013, gjykata vërtetoi faktin se L. M nga xhirlogaria e tij bankare, ka bartur në llogarinë bankare të F. R shumën e përgjithshme prej 30.000€, për kontratën me numër LRP.nr.1129/2013

Nga prokura me numër LRP.nr.2957/2013 e datës 23.10.2013 e vërtetuar pranë Noter B. I... në Gjilan, gjykata gjeti se B. M kishte autorizuar F. R që në emrin e tij me llogarinë e tij të mund ta përfaqësoj pranë të gjitha organeve dhe procedurave administrative lidhur me paluajtshmërinë e tij e cila gjendjes në zonën kadastrale të edhe atë sipas çertifikatë së pronës e datës 16.10.2013

Nga raporti i vlersimit të paluajtshmërisë me numër të lëndës 47/2013, e datës 01.11.2013 e lëshuar nga D. për U. K. dhe M. në Novobërdë, prona në fjalë ishte vlersuar në shumën prej 30.000€, edhe atë sipas çertifikatës së pronës e datës 16.10.2013.

Nga kontrata e shitblerjes së paluajtshmërisë me numër LRP.nr.1129/2013 dhe Ref.nr...., e datës 01.11.2018, e vërtetuar pranë Notere L. K... në , gjykata gjeti se B. M, në cilësi të shitësit të cilin me autorizim e përfaqësonte F. R, kishte lidhur kontratë të shitblerjes së paluajtshmërisë me blerësin L. M në shumën e përgjithshme prej 10.000€, e cila kontrtë është lidhur për pronat të cilat gjenden në çertifikatën e pronës së datës 16.10.2013, mirëpo e njejta kontratë nuk ka të bëjë me parcelat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Novo Bërd C.nr.50/2013 i datës 15.11.2013, gjykata ka konstatuar faktin se gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkespadinë e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të caktohet masa e përkohshme për parcelat.. në mes tjerash edhe parcelat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga çertifikata e pronës me numër ... e datës 12.06.2013, Z. K. ...Komunale Novo Bërd, gjykata ka vërtetuar faktin se parcelat evidentohen në emër të S.(J) S, ku në mesin e parcelave janë edhe parcelat si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e Shitblerjes së Paluajtshmërisë me numër LRP.nr.172/2013 dhe Ref.nr...., e datës 14.06.2013, e vërtetuar pranë Notere L. K..., gjykata vërtetoi faktin se në cilësin e shitësit Stojadin Steviq, kishte lidhur kontratë të shitblerjes së paluajtshme rivë me blerësin Sh. i, në shumën e përgjithshme prej 10.000€ edhe atë për parcelat:..... dhe ...

Nga kopja e letërnjoftimit e lëshuar nga M. i A së P.të K.të B...., gjykata vërtetoi faktin se i njejti letërnjofti është në emër të B. M.



Nga kopja e pasaportës e lëshuar nga autoritet sërbe me numër ... gjykata vërtetoi faktin se e njejta pasaportë është e lëshuar në emër të B. M.

Nga kopja e pasaportës e lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë, me numër ..., gjykata vërtetoi faktin se e njejta pasaportë është e lëshuar në emër të S. S, i lindur me datë 20.10.1959.

Nga kopja e pasaportës e lëshuar nga autortitet Austriake, me numër ..., gjykata vërtetoi faktin se e njejta pasaportë është e lëshuar në emër të S. S, i lindur me datë 23.07.1934.

Nga kopja e letërnjftimit e lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë, me numër ... i datës 19.06.1992, gjykata vërtetoi faktin se e njejta pasaportë është e lëshuar në emër të S. S, i lindur me datë 23.07.1934.

Nga raporti i hetuesit me numër ..., i datës 29.01.2014, gjykata vërtetoi faktin se oficeri policor-hetuesi R. R, për veprimet të cilat i ka ndërmarrë në kuadër të autorizimeve të tij, ku në fletën ecila në shkresa të lëndës evidentohet me numër ..., edhe atë ne pjesën e fundit në mes tjerash kanë evidentuar.. se i dyshuari F. R, ka gjetur edhe një person të Nacionalitetit Sërb, S.S-si shitës, kinse paluajtshmërinë e cila evidentohet në emër të S. S në fletën poseduese ... dhe ka gjetru një person tjetër Sh.M, Komuna e Gjilanit, si blerës të tërë paluajtshmërisë në fjalë dhe ka përpiluar kontratë tek dhe pasuria e S. S i cili gjindet në Austri si penzioner dhe bashkëshortja i jeton në ë, dhe kjo pasuri është bartur në emër të Sh. M.

Nga Certifikata e Pronësisë me numër ..., e datës 05.10.2017, gjykata gjeti se paluajtshmëria në fjalë me këtë datë evidentohet në emër të Sh. M. (Sh.) dhe atë me 1/1 e pjesës së pronësisë, në zonën kadastrale të, ku në këtë çertifikatë evidentohet parcela me numër ... në sipërfaqe prej 2075-m<sup>2</sup>.

### **Konstatimet e Gjykatës**

Gjykata i ka vlerësuar me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se i akuzuari Shaban Muji e ka kryer këtë vepër penale, legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Një gjendje e tillë faktike është vërtetuar nga dëshmitë dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Është jokontestuese fakti se i pandehuri F. R, me S. S dhe të akuzuarin Sh. M, me datë 14.06.2013, kanë shkuar tek zyrja e noteres L. K..., ashtu që S. S si shitës dhe Sh. M si blerës, kanë vërtetuar kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmësisë me numër Ref.nr.... LRP.nr. ... i datës 14.06.2013, edhe atë për parcelat ... ---...- ... dhe ...( në bazë të fletës poseduese me numër ... të datës 12.06.2013, përpos parcelave te cilat janë cekur në dispozitivin e këtij aktgjykimi, shihet se ka patur edhe parcela tjera, mirëpo të njejtat parcela nuk janë objekt i këtij aktgjykimi).

Po ashtu nuk është kontestues fakti se personi i paraqitur te noterja S. S... si shitës, me numër të pasaportës ..., i lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë, i njejtë është i lindur me datë 20.10.1959, dhe ky person e ka lidhur kontratën e lartcekur, ndërsa S. S, i vërtetë i njejtë jeton në shtetin e Austrisë, ku ky faktë është vërtetuar nga kopja e pasaportës e lëshuar nga autortitet Austriake, me numër P ... dhe i njejtë është i lindur me datë ..., po ashtu ky fakt është vërtetuar

edhe me kopjen e letënjofimit me numër CP ... i datës 19.06.1992, të lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë.

Me rastin e lidhjes së kontratës noterja ia ka kërkuar dokumentacionin përkatës, ashtu që personit të quajtur S. S, edhe pse noterja ia ka kërkuar letërnjoftimin i njejtë ia ka ofruar pasaportën me numër ..., e lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë, në emër të S. S, i lindur me datë ..., edhe pse në kontratën e lartcekur është evidentuar se origjinalit i janë bashkangjitur edhe këto dokumente, në mes tjerash edhe kopja e letërnjoftimit në emër të shitësit..., ku ky faktë vërtetohet në faqen 5 të kontratës së lartcekur(ndërsa me numër ... në bazë të shkresave të lëndës), ndërsa blerësi-i, i akuzuari Sh.M, i ka ofruar letërnjoftimin.

Në nenin 403 paragrafi 2 të KPRK-ës, në mënyrë shprehimore parashihet se “*Kushdo që përdorë dokumentin, regjistrimin apo librin e tillë edhe pse e di së është i rremë dënohet me dënim nga paragrafi 1 i këtij neni*”, e ku në paragrafin 1 të këtij neni parashihet” *Kushdo që vë në lajthim organin kompetent që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetojnë një çështje të pavërtetë, të paraparë për të shërbyer si provë një një çështje ligjore, dënohet me burgim prej 3 muaj deri në 5 vjet*”, andaj në rastin konkret lind pyetja se çfarë veprimesh ka ndërmarrë i akuzuari Sh. M, që ta ketë vënë në lajthim noterën, apo që të ketë patur njohuri se F. R dhe S. S, e kanë falsifikuar pasaportën me numër ..., në emër të S. S.

Por gjykata tezës së të akuzuarit me rastin e vendosjes i beson për faktet vendimtare të kësaj çështje: Anjëri nga dëshmitarët e dëgjuar në sallë si dhe të deklaratave të lexuara nuk e kanë identifikuar të akuzuarin, me të cilin supozohet ta ketë kryer veprën penale të lartcekur, asnjëri nga dëshmitarët nuk kanë mund të japin më të voglin element se i akuzuari Sh. M, ka ndërmarrë veprime që ta vë në lajthim noterën ngase i njejtë është paraqitur vetëm si blerës, dhe dokumentacionin të cilën ia ka kërkuar noterja ky ia ka ofruar.

Andaj gjykata konsideron se nuk do të thotë vetëm pse e ka patur një raport shoqëror i akuzuari Sh. M, me të pandehurin F. R, edhe ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet, i akuzuari Sh. M.

Andaj, provat e lartpërmendura nuk janë të mjaftueshme për ta vërtetuar dyshimin e bazuar se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale, ngase nuk është kontestuese fakti se personi i quajtur S. S me numër të pasaportës ..., është i lindur me datë 20.10.1959, dhe ky person është paraqitur tek noterja në cilësi të shitësit për shitjen e parcelave, ...--...--..., ..., , ... dhe..., mirëpo tek të dhënat personale në pasaportë nuk figuron emri i prindit, ndërsa te fleta poseduese me numër i datës 12.06.2013, figuron emri i prindit S. (J) S., ndërsa në bazë të kopjes së letërnjoftimit me numër CP ... i datës 19.06.1992, të lëshuar nga Republika Federative e Jugosllavisë, shihet se emri i prindit të S. S, është J., dhe nga ky fakt shihet se pronar juridik i parcelave të lartckeura është . S, është J., i lindur me datë ..., ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar asnjë element apo indicie se i akuzuari që ta ketë kryer veprën penale dhe si rezultat i vlerësimit të provave të administruara, gjykata ka ardhur në përfundim se edhe përkundër dyshimeve për përfshirjen e të akuzuarit në kryerjen e kësaj vepre penale, nuk u arrit që me provat e administruara në mënyrë bindëse të vërtetohet fajësia e tij.

Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij dhe bazuar në nenin 361 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat

e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Gjykata ka ardhur në përfundim të kësaj çështje penale-juridike se nuk ka prova të mjaftueshme, gjegjësisht të besueshme dhe të sigurta se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, si dhe duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 2 të KPP-ës, ku janë përcaktuar mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen konkrete interpretohen në favor të akuzuarve, andaj provat e siguruar nga prokuroria nuk janë të mjaftueshme, gjegjësisht të besueshme dhe të sigurta për të vërtetuar veprimet inkriminuese, se i akuzuari i lartcekur ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe në mungesë të provave tjera bindëse vendosi me aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nën paragrafi 1.3 të KPP-ës.

Ndërsa sa i përket provave tjera materiale, gjykata konsideron se të njëjtat ishin irelevante dhe të njëjtat nuk janë arsyetuar, ngase kanë patur të bëjnë me të pandehurin F. R, për shkak se procedura penale ndaj tij është vecuar.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata vendosi të të njëjtat të bien barrë e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata në bazë zë nenit 463 të KPP-së, të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civile.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**P.nr.556/2014,**  
**Me datë: 04.11.2020**

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Sabedin Mushica

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.